



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Udhëzues Pune

Ulja e dënimit

Miratoi:	Kryetarja, Dhomat e Specializuara të Kosovës
Data e miratimit:	3 korrik 2023
Data e hyrjes në fuqi:	3 korrik 2023
Zëvendëson:	nuk ka
Numri:	KSC-BD-48

Përmbajtja

KREU I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
NENI 1	QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI	2
NENI 2	PËRKUFIZIME	2
KREU II	LOTËSIMI I KRITEREVE PËR ULJEN E DËNIMIT	3
NENI 3	LOTËSIMI I KRITEREVE	3
KREU III	PROCEDURA PAS NJOFTIMIT PËR LOTËSIMIN E KRITEREVE	3
NENI 4	INFORMACIONI QË DUHET T’I JEPET PERSONIT TË DËNUAR	3
NENI 5	INFORMACIONI QË DUHET T’I DORËZOHET KRYETARIT	3
NENI 6	KËSHILLIMET ME GJYKATËSIT	4
NENI 7	KONFIDENCIALITETI	4
KREU IV	VENDIMI MBI ULJEN E DËNIMIT	4
NENI 8	INFORMACIONI QË SHQYRTOHET NGA KRYETARI	4
NENI 9	VENDIMI I KRYETARIT	5
NENI 10	MODIFIKIMI OSE NDRYSHIMI I DËNIMIT	5
NENI 11	KUSHTET E LIRIMIT	5
KREU V	DISPOZITA PËRFUNDIMTARE	6
NENI 12	MIRATIMI DHE NDRYSHIMET	6
NENI 13	VERSIONI AUTENTIK DHE HYRJA NË FUQI	6

KREU I Dispozita të përgjithshme**Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi**

Me këtë Udhëzues Pune, të miratuar në bazë të nenit 51 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 196 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), përcaktohet procedura për uljen e dënimeve të personave të shpallur fajtorë nga Dhomat e Specializuara.

Neni 2 Përkufizime

1. Termat e përdorura në këtë Udhëzues Pune kanë kuptimin që u jep Ligji dhe Rregulla 2 e Rregullores.
2. Krahas tyre, përdoren edhe përkufizimet e mëposhtme:

Person i dënuar një person të cilit i është shqiptuar dënim nga Dhomat e Specializuara

Shteti i kryerjes së dënimit një shtet i tretë i caktuar nga Kryetari i Dhomave të Specializuara, i cili ka shprehur gatishmërinë të pranojë personin e dënuar nga Dhomat e Specializuara, për zbatimin e dënimit me burgim

KREU II Plotësimi i kriterëve për uljen e dënimit

Neni 3 Plotësimi i kriterëve

1. Sipas rregullës 196(2) të Rregullores, pasi të ketë vuajtur dy të tretat e dënimit, ose 25 vjet në rastin e burgimit të përjetshëm, personi i dënuar i plotëson kriteret për shqyrtimin e uljes së dënimit. Në llogaritjen e masës së dënimit të vuajtur mbahen parasysh periudhat e lirimit të përkohshëm në bazë të nenit 56 të Rregullores, ose, sipas rastit, të lirimit të parakohshëm (me kusht).
2. Kur personi i dënuar i plotëson kriteret për ulje të dënimit sipas ligjit në fuqi të shtetit të kryerjes së dënimit, ai shtet, në përputhje me nenin 51(2) të Ligjit, rregullën 195 të Rregullores dhe marrëveshjen përkatëse me Dhomat e Specializuara, njofton Kryetarin, kur është e mundshme, së paku 100 ditë para datës së plotësimit të kriterëve.
3. Në rast se personi i dënuar i plotëson kriteret për ulje të dënimit gjatë kohës që vuan dënimin në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, Administratori njofton Kryetarin në lidhje me këtë së paku një muaj para datës së plotësimit të kriterëve.
4. Personi i dënuar mund të paraqesë kërkesë për ulje të dënimit nëse beson se i plotëson kriteret përkatëse. Në atë rast, Dhomat e Specializuara i kërkojnë shtetit të kryerjes së dënimit që të njoftojnë Dhomat e Specializuara nëse personi i dënuar i plotëson kriteret për ulje të dënimit sipas ligjeve të atij shteti.

KREU III Procedura pas njoftimit për plotësimin e kriterëve

Neni 4 Informacioni që duhet t'i jepet personit të dënuar

Pas marrjes së njoftimit për plotësimin e kriterëve, Kryetari i kërkon Administratorit që të informojë personin e dënuar për datën e plotësimit të kriterëve për ulje të dënimit, të sigurojë që personit të dënuar t'i jepet një kopje e këtij Udhëzuesi Pune në një gjuhë që personi i dënuar e kupton, dhe ta informojë për hapat e mëtejshëm që do të ndërmerren.

Neni 5 Informacioni që duhet t'i dorëzohet Kryetarit

1. Pas marrjes së njoftimit për plotësimin e kriterëve për ulje të dënimit, Kryetari i kërkon Administratorit që:
 - a. t'u kërkojë autoriteteve përkatëse në shtetin e kryerjes së dënimit raporte dhe vërejtje që lidhen me dispozitat (3)(a)-(c), (e), (j) dhe (k) të rregullës 196 të Rregullores;
 - b. sipas rastit, të dorëzojë raportin e Njesisë së Paraburgimit të Dhomave të Specializuara që lidhet me Rregullën 196 (3)(a)-(c), (e), (j) dhe (k) të Rregullores;
 - c. të dorëzojë informacion për vendin ku ka ndër mend të banojë personi i dënuar dhe vërejtje lidhur me Rregullën 196(3)(f) dhe (h) të Rregullores, si dhe për kushtet që mund të vendosen në bazë të nenit 8 të këtij Udhëzuesi Pune;
 - d. t'i kërkojë Prokurorit të Specializuar të dorëzojë raport në lidhje me çdo bashkëpunim të konsiderueshëm të personit të dënuar me Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe çfarëdo informacioni tjetër e vlerëson të rëndësishëm;

- e. sipas rastit, t'i kërkojë Mbrojtësit të Viktimave të dorëzojë raport që lidhet me Rregullën 196 (3)(i) të Rregullores; dhe
 - f. të dorëzojë çfarëdo informacioni tjetër që mund të jetë i rëndësishëm për vendimin e Kryetarit, si për shembull, nëse personi i dënuar i ka pranuar veprat penale për të cilat është dënuar dhe është penduar për to, si dhe çfarëdo informacioni në lidhje me gjasat që personi i dënuar të kryejë vepra penale.
2. Informacionin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, Administratori ia dorëzon Kryetarit brenda 21 ditësh nga data e marrjes së kërkesës për informacion, dhe një kopje të këtij informacioni ia përcjell personit të dënuar.
 3. Personi i dënuar mund t'i paraqesë Kryetarit parashtrime me shkrim brenda 14 ditësh pas marrjes së informacionit nga Administratori në një gjuhë që e kupton.
 4. Krahas parashtrimeve dhe vërejtjeve me shkrim, Kryetari mund të dëgjojë mendimin e personit të dënuar ose të cilitdo personi apo autoriteti tjetër që jep informacionin, me anë të videokonferencës, ose, nëse është e nevojshme, personalisht. Në rrethana të veçanta dhe në përputhje me Rregulloren, gjykatësi i caktuar nga Kryetari mund të mbajë seancë në lidhje me këtë në shtetin e kryerjes së dënimit, sikurse përcaktohet në rregullën 197(1) të Rregullores.

Neni 6 **Këshillimet me gjykatësit**

1. Kryetari u përcjell gjykatësve të panelit ose paneleve që kanë shqiptuar dënimin, të cilët janë në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë, kopje të informacionit të marrë në bazë të nenit 5(1) dhe (3) të këtij Udhëzuesi Pune, mendimin e Kryetarit nëse personi i dënuar ka treguar shenja rehabilitimi, informacion për faktorët e shqyrtuar në bazë të nenit 8 të këtij Udhëzuesi Pune, dhe informacione të tjera relevante.
2. Gjykatësit përkatës i paraqesin Kryetarit mendimin e tyre në lidhje me uljen e dënimit të personit të dënuar brenda shtatë ditësh nga marrja e informacionit të lartpërmendur.

Neni 7 **Konfidencialiteti**

1. I gjithë informacioni që i dorëzohet Kryetarit konsiderohet konfidencial, përveç kur vetë Kryetari autorizon nxjerrjen e tij.
2. Mbrojtësi i Viktimave mund të kërkojë që informacioni i dorëzuar në bazë të nenit 5(1)(e) të këtij Udhëzuesi Pune të mos i bëhet i njohur personit të dënuar. Kërkesa duhet të përmbajë justifikim të arsyetuar.

KREU IV **Vendimi mbi uljen e dënimit**

Neni 8 **Informacioni që shqyrtohet nga Kryetari**

Për marrjen e vendimit sipas nenit 10 të këtij Udhëzuesi Pune, Kryetari shqyrton informacionin e përcaktuar në rregullën 196(3) të Rregullores.

Neni 9 Vendimi i Kryetarit

1. Në përputhje me nenin 51(2) të Ligjit, në bazë të interesit të drejtësisë, parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe informacionit të marrë, dhe pasi të ketë marrë parasysh mendimet e gjykatësve të paneleve që kanë shqiptuar dënimin, Kryetari vendos nëse do të miratohet ulje e dënimit.
2. Kryetari u komunikon vendimin e arsyetuar të gjithë pjesëmarrësve në procedurë sa më shpejt që të jetë e mundur, në përputhje me rregullën 197(2) të Rregullores.
3. Vendimi bëhet publik dhe mund t'i bëhen redaktime, nëse është e nevojshme.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të apelohej.
5. Administratori ua përcjell menjëherë vendimin autoriteteve përkatëse të shtetit të kryerjes së dënimit, të cilat zbatojnë kushtet e vendimit pa vonesë në përputhje me marrëveshjen e atij shteti me Dhomat e Specializuara. Një kopje e vendimit i dorëzohet personit të dënuar.
6. Sipas nevojës, Administratori, përmes Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, informon dëshmitarët që kanë dëshmuar para Dhomave të Specializuara në çështjen gjyqësore të personit të dënuar, si edhe viktimat pjesëmarrëse në atë çështje gjyqësore, për lirimin e personit të dënuar, shtetin e banimit, dhe për çfarëdo hollësie tjetër relevante, për të garantuar sigurinë e dëshmitarëve.

Neni 10 Modifikimi ose ndryshimi i dënimit

Kur konstaton se ulja e dënimit nuk është e përshtatshme, Kryetari mund të vendosë ta modifikojë ose ndryshojë dënimin, në përputhje me nenin 51(2) të Ligjit.

Neni 11 Kushtet e lirit

1. Nëse merret vendim për modifikimin ose ndryshimin e dënimit të personit të dënuar, Kryetari mund të vendosë kushte në lidhje me të në përputhje me rregullën 196(4) të Rregullores, të zbatueshme deri në datën e përfundimit të dënimit të formës së prerë, ose deri në një datë tjetër të mëhershme të specifikuar. Këto kushte mund të përfshijnë:
 - a. Garancinë se do të banojë tërë kohën në vendbanimin e specifikuar;
 - b. njoftimin e Dhomave të Specializuara për ndërrimin e vendbanimit të përhershëm;
 - c. njoftimin e Dhomave të Specializuara për udhëtimet jashtë Kosovës ose jashtë shtetit të banimit;
 - d. paraqitjen e rregullt në stacionin e policisë në vendin ku banon;
 - e. që personi i dënuar të mos kontaktojë apo komunikojë me dëshmitarët ose viktimat;
 - f. që personi i dënuar të mos bëjë deklaratë publike në lidhje me Dhomat e Specializuara të cilat mund t'u shkaktojnë viktimave frikë për të bërë kërkesë për pjesëmarrje në procese, apo t'u shkaktojnë njerëzve frikë për të bashkëpunuar, ose t'i bindin dëshmitarët që të mos japin dëshmi para Dhomave të Specializuara;
 - g. që personi i dënuar të mos shkelë asnjë urdhër të Dhomave të Specializuara;
 - h. që personi i dënuar të mos bëjë komente ose sjellje të dhunshme, frikësuese, kërcënuese ose shtrënguese ndaj dëshmitarëve ose personave të tjerë që janë të rrezikuar për shkak të bashkëpunimit të tyre me Dhomat e Specializuara, ndaj zyrtarëve të Dhomave të Specializuara ose të Zyrës së Prokurorit të Specializuar; ose
 - i. çfarëdo kushtesh të tjera proporcionale që gjykohen të nevojshme.

2. Mosrespektimi i cilitdo prej këtyre kushteve mund të sjellë si pasojë anulimin ose modifikimin e vendimit sipas këtij neni.

KREU V Dispozita përfundimtare

Neni 12 Miratimi dhe ndryshimet

Kryetari miraton këtë Udhëzues Pune dhe mund ta ndryshojë atë *proprio motu*.

Neni 13 Versioni autentik dhe hyrja në fuqi

1. Versioni autentik i këtij Udhëzuesi Pune është versioni në gjuhën angleze.
2. Ky Udhëzues Pune dhe çdo ndryshim i tij hyn në fuqi në ditën e publikimit.

Hagë, Holandë

3 korrik 2023

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara